



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më ____ . ____ .2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

PËR

**“MIRATIMIN E KRYERJES ME PRORITET TË INVESTIMIT ME OBJEKT:
“GRUMBULLIM DHE TRANSPORT I MBETJEVE URBANE PËR VITET 2025-2027”**

Në mbështetje të nenit 23 pika 10 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit nr.156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 12, 41 dhe 85 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar në “Planin për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Prrenjas 2025-2029” si dhe referuar Kërkesës me nr.2721 prot, datë 25.10.2024, me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt:“Pastrim, grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane nga qyteti Prrenjas për në incenerator Elbasan” të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Grupi i punës për përlogaritjen e kostos së shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Financës si dhe Sektori i Prokurimeve, në mbledhjen e datës ____ . ____ . 2024,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI :**

1. Të miratojë kryerjen me prioritet të investimit me objekt: “Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025-2027”.

2.Fondi financiar për kryerjen e këtij investimi, mbështetet në PBA dhe Buxhet.

Ndarja e fondeve dhe efektet financiare e përlogaritur sipas viteve buxhetore:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera e plotë (lekë me tvsh)	Për tu financuar në buxhetin e vitit 2025	Për tu financuar në buxhetin e vitit 2026	Për tu financuar në buxhetin e vitit 2027
1.	“Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025-2027”	47,003,885	15,667,961	15,667,961	15,667,961

3. Të autorizojë administratën e Bashkisë për kryerjen e procedurës së prokurimit me vlerë të plotë 47,003,885 lekë me TVSH, për realizimin e këtij shërbimi, sipas bazës ligjore në fuqi për prokurimet.

4. Efektet financiare për këtë shërbim do të garantohen nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas sipas strukturës së llogarisë 00-01-05100-602.

5. Ngarkohen me zbatimin e vendimit Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Financës dhe Sektori i Prokurimeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Konceptoi: Ahmet Goçi
Artin Blloshmi
Merita Rira

Pranoi: Ervin Vasku
Gordana Karaj
Suzana Kapxhiu
Zamira Cekrezi

KRYETARI I BASHKISË
MURRI BELBA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

“Mbi dhënien e ndihmës ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike muaji TETOR 2024”.

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ‘ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë’, bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në.9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
4. Familje me shumë fëmijë
5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike për muajin **TETOR**, **48** familje me fond **259.094 LEKË**.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.

Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA

Kryetari i Bashkisë

NURBELBA

4 PRRENJAS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRRENJAS

Nr.....prot.

Përrenjas, më/...../2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

“Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga Fondi Social”

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ‘Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë’, bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat janë refuzuar për shkaqe administrative nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe administrative dhe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019“Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar(apo në burg)dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat perkatës.
4. Familje me probleme të tjera sociale.

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga Fondi Social i ndihmës ekonomike për muajin **TETOR**, 9 familje me fond 62.000 LEKË.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.
Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë _____

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË QIRASË MESATARE TË NJËSIVE TË BANIMIT DHE APARAMENTEVE NË TREG, PËR EFEKT SUBVENCIONIMI TË QIRASË NË BASHKINË PRRENJAS

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr.22/2018 në datën 3.5.2018 “Për Strehimin Social”, VKM Nr .362 dt 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin qirasë në tregun e lirë ,nëpërmjet buxhetit të shtetit ,dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,VKM Nr 459 dt 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të vetqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për Strehimin”. Referuar kontratave dhe ofertave të marra në treg për çmimin e qirave në qytetin e Prrenjasit dhe rrethe për vitin kalendarik 2024, I propozojë Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës / /2024

TË VENDOSI:

1.Miratimin e çmimit mesatar të qirave të banesave për efekt subvencionimi të qirasë sipas strukturës:

- Për apartamente të tipit “Garsionere” - 8000 lekë
- Për apartament të tipit 1+1 - 12000 lekë
- Për apartament të tipit 2+1 - 15000 lekë
- Për apartament të tipit 3+1 - 16000 lekë

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Shërbimit Social dhe Strehimit ,Drejtoria Juridike.

3.Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Specialiste e Strehimit **E. KRYEZIU**

Pranoi: Përgjegjës i Shërbimit Social dhe Strehimit **B.HANA**

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV.KRYETARI I BASHKISË

Aurel KARRIOTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL DHE STREHIMIT

Nr. _____ prot.

Prenjas, më _____.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIM QIRAJE PËR VITIN 2024 NË QYTETIN E PRRENJASIT”**

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM nr.362 datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfiturat strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKB Prenjas Nr.45, datë 27.03.2024 “Për miratimin e Sistemit të Pikëzimit për familjet/individët që kërkojnë të përfitojnë nga programi i subvencionimit të qirasë”, VKB Prenjas nr.26, datë 07.02.2020 “Për përcaktimin e çmimit të qirasë të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionit të qirasë”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.443, date 02.10.2024 për “Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2024”, Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit i Propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij më datë ____/____/2024 të miratojë:

1. Listën emërore shtesë të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje për vitin 2024. (Bashkangjitur tabela me listën emërore dhe shumat e subvencionimit).
2. Miratimin në parim të masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale prej **40000** lekë për periudhën (Shtator-Dhjetor) viti 2024, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **32000** lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Prenjas në vlerën **8000** lekë.
3. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për Komisionin e Strehimit 2024
4. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konceptoi: SPECIALISTI I STREHIMIT I PRRENJES
Miratoi: PËRGJEGJËSI I SHËRBIMIT SOCIAL B.HANA

NË MUNGESË DHE NË URDHËR
Z. KRYETARI I BASHKISË
AURD KARRIQI

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRRENJAS

Nr. _____ Prot.

Përrenjas, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

“PËR MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT QË NDJEKIN VITIN E PARË NË SHKOLLAT E MESME TË ARSIMIT PROFESIONAL PËR VITIN MËSIMOR 2024-2025”

Në zbatim të ligjit 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, V.K.M-së nr.666, datë 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar referuar shkresës së Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025 me nr.13089/1 prot, datë 23.10.2024 protokolluar me tonën me nr 2699 prot, datë 24.10.2024.

Numri i aplikimeve për shkollat profesionale në Bashkinë Përrenjas është .

Në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Bashkisë ____ . ____ .2024;

PROPOZOJMË:

Miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore, në shkollat e mesme të arsimit profesional, për vitin shkollor 2024-2025.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Konceptoi:

Armando Kryeziu- Specialist Arsimi

KRYETARI I BASHKISË

NURI BEÇIRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRRENJAS

Nr. ____ prot

Përrenjas, më ____ / ____ /2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, Datë ____ / ____ /2024

PËR

“MIRATIMIN PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE TË MARRJES ME QIRA TË AMBJENTEVE QË DO TË PËRDOREN PËR NEVOJAT E SHKOLLAVE NË TËRRITORIN E BASHKISË PËRRENJAS”.

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9 pika 1.6/a, neni 54/k dhe neni 64/a, b, gj, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr. 6 datë 27.12.2023 “Për miratimin përfundimtarë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti 2024, konfirmuar me shkresën nr. 69/1 prot, datë 12.01.2024 nga Prefekti i Qarkut Elbasan referuar dhe kërkesave nga Drejtoria e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Sali Halili”, Rrajcë-Fushë, Njësia Administrative Rrajcë e nr. 2941 prot, datë 18.11.2024, kërkesave nga Drejtoria e Shkollës 9-vjecare Rrajcë-Fushë nr. 2941 prot, datë 18.11.2024, kërkesa nga Drejtoria e shkollës së mesme të bashkuar “Dilaver Nezha”, Qukës Shkumbin, Njësia Administrative Qukës nr. 2948 prot, date 19.11.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Përrenjas që në mbledhjen e datës ____ / ____ /2024,

KËSHILLI BASHKIAK

Vendosi:

1. Të miratojë rinovimin e kontratës për marrjen me qira të ambjenteve që do të përdoren për nevojat e “Shkollës 9- vjeçare, Rrajcë –Fushë” për vitin 2025, fondi: 45.000 lekë (dyzet e pesëmijë) lekë/ muaj.
2. Të miratojë rinovimin e kontratës për marrjen me qira të ambienteve që do të përdoren për nevojat e “Shkollës së mesme të bashkuar „ Sali Halili“, Rrajcë-Fushë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Përrenjas, për vitin 2025, fondi: 55.000 (pesëdhjet e pesë mijë) lekë në muaj.
3. Të miratojë rinovimin e kontratës për marrjen me qira të ambienteve që do të përdoren për krijimin e ambienteve që do të përdoren për nevojat e “Shkollës së mesme të bashkuar „Sali Halili“, Rrajcë-Fushë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Përrenjas, për vitin 2025, fondi: 14.000 (katërmbëdhjet mijë) lekë/ muaj.

12024

Të miratojë rinovimin e kontratës për marrjen me qira të ambienteve që do të përdoren për nevojat e shkollës së mesme të bashkuar "Dilaver Nezha", Qukës Shkumbin, Njësia Administrative Qukës, Bashkia Prrënjas, për vitin 2025, fondi: 14.000 (katërmbëdhjet mijë) lekë/muaj.


5. Fondi prej 45.000 lekë (dyzet e pesëmijë) lekë në muaj , fondi 55,000 lekë (pesëdhjet e pesë mijë) lekë/muaj, fondi: 14.000 (katërmbëdhjet mijë) lekë në muaj, fondi: 14.000 (katërmbëdhjet mijë) lekë në muaj do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Prrënjas në strukturën e llogarisë 00-1110-602 në zërin shpenzime qira ambjentesh të marra nga Bashkia Prrënjas. Në vijim do të planifikohet fondi në buxhetin e vitit pasardhës deri në momentin që shkolla të mos ketë nevojë për ambiente shtesë.
6. Afati i kontratave do të jetë për një kohëzgjatje jo më shumë se një vit referuar VKM nr. 54 date 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
7. Ngarkohen me zbatimin e vendimit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Arsimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

SEKTORI I ARSIMIT

Konceptoi : Arsen Karriqi

Pranoi: A.Rira

Me respekt,
KRYETARI I BASHKISË
NUEJ BELEBA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Nr. _____ Prot.

Prrenjas, _____, 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë _____ / _____ / 2024


“PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE SHKAKTUAR NGA DJEGJA
NË BANESËN E Z.Kloian Bogdani, BANOR I FSHATIT RRAJCE NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRAJCE BASHKIA PRRENJAS DHE SHPËRBLIMIN E PLOTË NGA
ANA E BASHKISË PRRENJAS”


Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-në Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqsi natyrore ose fatkeqsi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe relacionit të mbajtur nga Komisioni i ngritur me Urdhër NR 431, datë 24.09.2024 nga Kryetari i Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e gjëndjes dhe vlersimin e dëmeve shkaktuar renia e zjarrit në banesën e KLODIAN BOGDANI”, Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Financës,

i propozon Këshillit Bashkiak:

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga dëmtimi i banesës nga renia e zjarrit në shumën 161340.5 leke cila është 50% e vlerës së preventivit të hartuar nga ekspertet (322681 x 50 % = 161340.5 leke me t,v,sh

2. Miratimin për dhënien e ndihmës së plotë financiare, në shumën 161340.5 lek (me T,V,Sh nga fondi i Kushtezuar i Emergjencave Civile të Bashkisë Prrenjas.

Konceptoi: Sp.MC, Dritan Karriqi 

Pranoi: Përgjegjesi i Mbrojtjes Civile
Pasho Kushta 

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

NURIELBA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ prot

Prrenjas, më ____/____/2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/2024

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE BUXHETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË PRRENJAS PËR VITIN 2025”.

Në mbështetje të Ligjit NR. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, pika “dh”, Ligjit NR. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” me propozim të Kryetarit të Këshillit i kërkohet Këshillit Bashkiak Prrenjas që në mbledhjen e datës ____/____/2024 të miratojë:

1. Miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetin e Këshillit Bashkiak Prrenjas për vitin 2025, sipas formateve bashkëlidhur dhe relacionin shpjegues.
2. Miratimin e Planit të punës dhe buxhetin vjetor të Këshillit Bashkiak Prrenjas.
3. Miratimin e Kalendarit, cikli i buxhetit, normat dhe planet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ Prot.

Prrenjas, më _____ / _____ /2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, Datë _____ / _____ /2024

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE,
EKONOMIA PYJORE “SOPOT”, BASHKIA PRRENJAS”.

Të nderuar këshilltarë !

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përfundimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtarë”, të kontratës Nr.3133, datë 14.11.2023 “Kontratë Publike Për Shërbime”, lidhur ndërmjet “Autoritetit Kontraktor” Bashkia Prrenjas, me NIPT K57904612U dhe “Kontraktuesit”, subjektit “Lurimi” sh.p.k, Burrel-Albania, me Nipt J68403912U me adresë: Diber Burrel BURREL, Lagja Drita, ish Rreparti Ushtarak Burrel, me administrator z.Lutfi MIFTARI, objekt: “Për hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore” (Sopot), Bashkia Prrenjas me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit dhe kullotave, pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Prrenjas që në mbledhjen e datës ___/___/2024 të miratojë:

1. Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Ekonomisë Pyjore “SOPOT” të hartuar nga Subjekti “Lurimi” sh.p.k, Burrel-Albania, me Nipt J68403912U.
2. Ngarkohen me zbatimin e vendimit Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave/, pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, dhe Sektori Juridik, Bashkia Prrenjas.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

DREJTORI I DR.ZHVILLIMIT EKONOMIK,
BUJQËSISË DHE TURIZMIT
Leonard LOSHI

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____, 2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK (5 – VJEÇAR) TË BASHKISË PRRENJAS”

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54 pika dh, Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 7, 48, Ligji Nr.9936 Datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 5 Datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendore 2024-2026”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga grupi i Menaxhimit të Riskut pranë Bashkisë Prrenjas, në mbledhjen e datës _____, 2024,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Të miratojë Planit Strategjik (5 – Vjeçarë) të Bashkisë Prrenjas.
2. Ngarkohen të gjitha strukturat përfshirë edhe njësitë vartëse të bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Bashkangjitur relacioni dhe Plani Strategjik i Bashkisë Prrenjas.

Kryetari i Grupi Menaxhimit të Riskut

Aurel Kariqi

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA